



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:059184

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06003237

KPPP.nr.361/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit "Prishtina" SH.A., me seli në Prishtinë, rruga "Hazir Shala" nr.4, kundër debitorit "A...P...", me NUI: 811390062, me seli në Podujevë, fshati Sallabajë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Rexhep Potera, avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas prapësimit të ushtruar kundër lejimit të ekzekutimit të Urdhrit Përmbartimor P.nr.266/21 të datës 04.02.2021 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "A...P...", i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.266/21 të datës 01.02.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.266/21 të datës 01.02.2023, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit "Prishtina" SH.A., ka caktuar urdhrin P.nr.266/21 me datën 04.02.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Ekstrakt nga Librat e Kontabilitetit me Nr. K 023376, me të cilën është obliguar debitori, që të në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 901.42 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtu që përmbartimi të realizohet me bllokimin e xhirollogarive bankare të

debitorit, regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe identifikimin, shënimin e përmbarimit në librin publik të paluajshmërive që do të gjenden në pronësinë e debitorit dhe shitjen e sendeve për përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit.

Debitori ka paraqitur prapësim, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar se kërkesa e kreditorit është e parashkruar, po ashtu është cenuar neni 9 i LPP-së, duke tentuar që të përfitojnë në mënyrë të kundërligjshme. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor si dhe të detyrohet kreditori që t'ia kompensoj debitorit shpenzimet e procedurës si dhe të përfaqësimin.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin me të cilën e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, duke theksuar se kërkesa nuk është e parashkruar pasi që debitori është biznes dhe nuk vlen afati 1 vjeçar i parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, me aktvendimin PPP.nr.286/2021 të datës 07.09.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.266/21 të datës 04.02.2021.

Debitori ka parashtruar ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, PPP.nr.286/2021 të datës 07.09.2021, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovoj ankesën e debitorit, të anulohet të gjitha veprimet e kreditorit dhe ta detyroj kreditorin që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.305/22 të datës 06.10.2022, e ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, PPP.nr.286/2021 të datës 07.09.2021, e ka vërtetuar.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas parashtresës së kreditorit për shtrirjen e përmbarimit ndaj pronarit të biznesit, me urdhrin P.nr.266/21 të datës 01.02.2023, ka lejuar propozimin e kreditorit për shtrirjen e përmbarimit ndaj pronarit të biznesit.

Debitori me datë 15.02.2023, ka parashtruar prapësim kundër urdhrit P.nr.266/21 të datës 01.02.2023 me të cilin është lejuar ekzekutimi i propozuar nga ana e kreditorit, duke theksuar se kreditori kundërligjshëm po e kërkon ekzekutimin e urdhrit përmbarimor, pasi që në këtë çështje ka vendim të formës së prerë dhe e njëjta përbën çështje të gjykuar. Ka shtuar po ashtu se borxhi është i parashkruar në kuptim të nenit 360 par. 1 nën par. 1.1 të LMD-së. Tutje ka deklaruar se për të njëjtën çështje debitori ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, andaj gjykatës i ka propozuar që ta anuloj urdhrin përmbarimor P.nr.266/21 të datës 01.02.2023, dhe të vërtetoj se debitori nuk ka obligim ndaj kreditorit, si dhe ta detyroj që t'ia kthej debitorit shumën për shkak të pasurimit të pabazë.

Gjykata gjeti se objekt trajtimi në këtë procedurë është prapësimi i debitorit i parashtruar me datë 16.02.2023, kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat për shtrirjen e përmbarimit edhe ndaj pronarit të biznesit dhe pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të ngritur në këtë prapësim, dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata nga shkresat e lëndës gjeti se debitori në këtë çështje përmbarimore me datë 22.02.2021 ka paraqitur prapësimin kundër urdhrit përmbarimor P.nr.266/21 të datës 04.02.2021, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë me Aktvendimin PPP.nr.286/2021 të datës 07.09.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit. Ndaj këtij vendimi debitori ka ushtruar ankesë e cila me Aktvendimin K.D.SH.II.nr.305/22 të datës 06.10.2022, të Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, është refuzuar si e pathemeltë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë PPP.nr.286/2021 i datës 07.09.2021, është vërtetuar. Ndërsa pas vendosjes sipas ankesës së debitorit, Përmbaruesi Privat ka nxjerrë urdhrin P.nr.266/21, vetëm sa i përket shtrirjes së përmbarimit ndaj pronarit të biznesit.

Me qëllim të vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të paraqitura në prapësimin e ushtruar nga debitori ndaj urdhrit të Përmbaruesit Privat P.nr.266/21 të datës 01.02.2023, gjykata fillimisht konstatoi se palë debitore në procedurën përmbarimore sipas urdhrit përmbarimor P.nr.266/21, identifikohet biznesi N.T.SH. " A...P... " me numër unik identifikues 810785967, me pronar N.A., i cili në regjistrin publik të ARBK-së, figuron i regjistruar si biznes individual.

Andaj duke marrë parasysh se në rastin konkret në cilësinë e debitorit në këtë çështje përmbarimore është N.T.SH. " A...P... ", i organizuar në formën e biznesit individual, i cili nuk ka subjektivitet të ndarë nga pronari i tij, gjykata vlerëson se N.A., si pronar i biznesit individual është personalisht përgjegjës për të gjitha detyrimet e krijuara në emër të këtij biznesi, konform nenit 48 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare më të cilin përcaktohet se: *“Një person mund të ketë vetëm një Biznes Individual. Personi i cili është pronar i një Biznesi Individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë, në një Biznes Individual”*.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e debitorit sipas të cilit kreditori ka paraqitur dy herë radhazi propozimin për përmbarim për të njëjtën çështje dhe të njëjtin borxh, mirëpo gjeti se ky pretendim është i pabazuar sepse në rastin konkret nga arsyet e lartcekura rezulton se kreditori nuk ka paraqitur propozim të ri për ekzekutimin e borxhit të njëjtë, por ka ndërmarrë veprime me qëllim të realizimit të detyrimit/borxhit nga ana e debitorit, të vendosur në procedurën e përmbarimit sipas Aktvendimin PPP.nr.286/2021 të datës 07.09.2021, i vërtetuar me Aktvendimin K.D.SH.II.nr.305/22 të datës 06.10.2022, të cilin nuk ka mundur ta realizoj as pas përfundimit të kësaj procedure.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.361/23, datë 31.07.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.